KONTRATË SHITJEJE KUOTASH

ndërmjet

Z. Grigor Joti

dhe

Z. Bledar Dhima

Datë 08.05.2023

Kjo Kontratë Shitjeje Kuotash (në vijim "**Kontrata**") nënshkruhet sot më datë 08.05.2023 ("**Data e Nënshkrimit**") nga dhe ndërmjet palëve si më poshtë (në vijim secila palë më poshtë do të referohet veçmas si "**Pala**" dhe së bashku "**Palët**" siç mund ta kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Kontrate):

1. **Z.Grigor Joti**, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në TIRANË, me adresë Rr.Seit Teqja 03950073; Nd. 134; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 13/02/1956, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032495475 dhe nr. personal F60213094Q (referuar si "**Shitësi**").

E pranishme:

2. **Znj.Marjeta Joti**, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Rr Seit Teqja 03950073; Nd. 134; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 13/04/1962, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034901970 dhe nr. Personal G25413134Q e cila jep pelqimin dhe miratimin e saj per nenshkrimin e kesaj Kontrate.

Nga ana tjeter:

3. **Z.Bledar Dhima**, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë, Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Faik Konica; Nd. P.Kulla 2; Ap. Ap.23; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 28/02/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte me nr. BR0013376 dhe nr. personal H00228125G (në vijim referuar si "**Blerësi**").

E pranishme :

4. **Znj.Mirela Dhima,** shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Faik Konica; Nd. P.Kulla 2; Ap. Ap.23; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 28/08/1974, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me pasaporte me nr. BR9998160 dhe nr. personal H45828045A, e cila jep pelqimin dhe miratimin e saj per nenshkrimin e kesaj Kontrate.

MEQENËSE:

- Shitësi eshte ortak në Shoqëri (sipas përkufizimit të dhënë më poshtë) dhe zotërues i kuotes në masën totale 55% (pesëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit të saj dhe dëshiron të shes nje pjese te Kuotes (sipas përkufizimit të dhënë më poshtë);
- Blerësi është i interesuar të blejë nga Shitësi nje pjese te Kuotes (sipas përshkrimit dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë);

ATËHERË, në bazë të kushteve, të drejtave, detyrimeve, deklarimeve dhe garancive të shprehura në këtë Kontratë, Palët bien dakord si më poshtë:

KREU I. HYRJA, INTERPRETIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1.01 Hyrja

Të gjitha parashtrimet e mësipërme që janë përfshirë në hyrjen e kësaj Kontrate janë pjesë integrale e saj.

Neni 1.02 Interpretimi

(a) Kontrata si e Tërë. Çdo e drejtë, detyrim, apo kusht i përshkruar në këtë Kontratë duhet të interpretohet në kontekstin e Kontratës të marrë si e tërë dhe duke marrë në konsideratë qëllimet që nxitën Palët për të hyrë në këtë Kontratë.

(b) Titujt, Krerët, Nenet, Paragrafët. Titujt e krerëve, neneve, paragrafëve, nënparagrafëve që përmban kjo Kontratë si dhe ato që janë në tabelën e lëndës janë vetëm për referencë dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin apo interpretimin e kësaj Kontrate.

(c) Shtojcat. Të gjitha anekset dhe shtojcat bashkëngjitur apo referuar, janë inkorporuar dhe janë pjesë integrale e kësaj Kontrate. Nëse një fjalë e përdorur në ndonjë aneks apo shtojcë fillon më gërmë kapitale por nuk është e përkufizuar në këtë aneks apo shtojcë, do të ketë kuptimin e përkufizuar në këtë Kontratë. Kur në tekstin e kësaj Kontrate ka referenca për një kre, nen, paragraf, nënparagraf, aneks, shtojcë, të tilla referenca lidhen me kreun, nenin, paragrafin, nënparagrafin, aneksin apo shtojcën e kësaj Kontrate, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

(d) Interpretimet Gramatikore. Përveçse në rastet kur thuhet shprehimisht ndryshe, në Kontratë:

(i) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;

(ii) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;

(iii) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkatës;

(iv) Fjala "përfshin", do të thotë "përfshin, pa u kufizuar", pavarësisht nëse ndiqet nga ai togfjalësh apo jo; dhe

(v) Fjalët e përdorura në këtë Kontratë dhe që janë përkufizuar në Kontratën e Kredisë, nëse nuk parashikohet ndryshe, do të kenë të njëjtin kuptim.

Neni 1.03 Përkufizimet

- "**Çmimi**" ka kuptimin e dhënë te Neni 3.01 (*Çmimi*) i kësaj Kontrate.
- "**Data e Nënshkrimit**" ka kuptimin e dhënë në hyrje të kësaj Kontrate.

- "**Dëm**" i referohet çdo dëmi kontraktor ose jashtëkontraktor, kosto, shpenzimi të kryer, pagese, humbje ose detyrimi i cili është pasojë direkte ose e tërthortë e shkeljes së deklaratave, garancive apo zotimeve të kësaj Kontrate, përfshirë shpenzimet e kryera për të parandaluar apo përballuar Pretendimet që sjellin shkaktimin e këtij Dëmi apo për të adresuar pasojat e tij.
- "**Ditë Pune**" do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare në Republikën e Shqipërisë.
- "**Forca Madhore**" në këtë Marrëveshje do të konsiderohet një ngjarje apo situatë që (i) është e paparashikueshme, (ii) është jashtë kontrollit të Palës që e pretendon forcën madhore dhe nuk është shkaktuar për faj të saj, (iii) ka ndikim direkt mbi Palën që e pretendon forcën madhore, dhe (iv) bën të pamundur përmbushjen e detyrimit nga ana e Palës që pretendon forcën madhore. Për ilustrim, Forca Madhore mund të përfshijë (v) aktet e luftës, terrorizmit, revoltat civile, veprimet e elementeve të natyrës (p.sh. zjarri, përmbytja, stuhia etj.), (vi) epidemi, pandemi apo (vii) vendosja e masave të jashtëzakonshme sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- "**Klient**" ka kuptimin e Personave me të cilët Shoqëria bashkëpunon për të ushtruar veprimtarinë e saj, duke iu shitur, blerë apo furnizuar mallra, produkte dhe shërbime.
- **"Kuota"** ka kuptimin e kuotes të zotëruar deri në Datën e Nënshkrimit nga Z. Grigor Joti, në masën 55% për qind të kapitalit të Shoqërisë dhe pronësia e të ciles do t'i kalohet pjeserisht Blerësit me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
- "**Legjislacion i Zbatueshëm**" do të thotë çdo ligj, akt nënligjor, akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, çdo vendim gjyqësor apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo Personi të krijuar me ligj, (qoftë i pavaruar apo jo), që ka juridiksionin përkatës mbi Palët, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.
- "**Ligji për Shoqëritë Tregtare**" ka kuptimin e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar.
- "**Person**" do të thotë çdo individ, person fizik, shoqëri tregtare, ortakëri e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm ose ai i një vendi specifik, përfshirë Entitetet Qeveritare.
- "**Pretendim**" do të thotë çdo ankesë, padi, pretendim, kërkesë për dëmshpërblim, në gjykatë, gjykatë arbitrazhi, Entitet Qeveritar apo në çdo institucion a organizëm që merr vendime të ngjashme dhe që ka juridiksion mbi Palët.
- "**Shoqëria**" ka kuptimin e shoqërisë "Infosoft Systems" sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në QKB dhe e identifikuar me NUIS J61820021C, me seli në adresën: Tiranë, Rruga Murat Toptani,Gjergji Center.
- "**QKB**" ka kuptimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit në Republikën e Shqipërisë, si entiteti përgjegjës për mbajtjen e regjistrit tregtar në Shqipëri, apo çdo entiteti që mund ta zëvendësojë atë në të ardhmen.

KREU II. OBJEKTI I KONTRATËS

Neni 2.01 Objekti i Kontratës

(a) Objekti i kësaj Kontrate është shitja nga Shitësi i nje pjese te Kuotes të zotëruar në Shoqëri te Blerësi, dhe konkretisht 33.34% te saj, qe perben 18.337% te kuotave totale te Shoqërise, duke paguar ky i fundit Çmimin e parashikuar te KREU III (*Çmimi dhe Mënyra e Pagesës*), në përputhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e tjera të parashikuara në këtë Kontratë.

KREU III. ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

Neni 3.01 Çmimi

(a) Shuma e Çmimit. Shitësi bie dakord t'i shese Blerësit, dhe Bleresi bie dakord qe per pjesen e kuotes qe do te bleje ti paguaje Shitesit cmimin prej 110,022,000 lek plus nje vlere te barabarte me 9.1685% të fitimit te kompanisë, për cdo periudhe per 3 vitet e ardhshme, duke filluar nga dita e nenshkrimit te kesaj kontrate. Palet bien dakord qe mund te ndryshojne cmimin e kontrates, sipas marreveshjes qe palët do te nenshkruajne.

Neni 3.02 Mënyra e Pagesës

(a) Pagesa e Çmimit. Palët do të likuidojnë Çmimin në Llogarinë e Shitësit sipas kësteve dhe afateve të parashikuara më poshtë.

(b) Këstet dhe Afatet. Blerësi do të paguajë Çmimin sipas kësteve dhe afateve të mëposhtme:

- *Kesti i pare*: Brenda 30 ditesh nga nenshkrimi i kontrates, Bleresi paguan pjesen nominale te kapitalit prej 110,022,000 lek.
- *Kesti i dyte*: Në vitin 2024 paguhet 9.1685% të fitimit te kompanisë te periudhes nga dita e nenshkrimit te kontrates deri ne fund te 2023.
- *Kesti i trete:* Ne vitin 2025 paguhet 9.1685% të fitimit te kompanisë per vitin 2024.
- *Kesti i katert*: Ne vitin 2026 paguhet 9.1685% të fitimit te kompanisë per vitin 2025.
- *Kesti i peste:* Në vitin 2027 paguhet 9.1685% të fitimit te kompanisë te periudhes nga fillimi i vitit 2026, deri ne diten dhe muajin e vitit 2026, qe perkon me diten dhe muajin e nenshkrimit te kontrates. *(referuar bashkërisht si "Këstet" dhe veç e veç si "Kësti").*

Pagesat e mesiperme do te behen sipas ketij rregulli:

- Per cdo vit, per cdo x% te dividentit qe kompania do te shperndaje nga fitimi i vitit te meparshem, Bleresi duhet te paguajne Shitesin, brenda 7 ditesh kalendarike, me x% te pjeses prej 9.1685% te fitimit te kompanise. Gjithesesi, nese kompania nuk do te shperndaje gjithe fitimin e nje viti, si divident ne vitin pasardhes, Bleresi do ti paguaje Shitesit te gjithe vleren e detyrimit te nje viti, jo me vone se 31 dhjetori i vitit pasardhes.

(c) Palët mund të bien dakord të ndryshojnë afatet e pageses me amendament te nenshkruar ndermjet tyre.

(d) Ne rast se per arsye objektive, Shoqeria Infosoft Systems shpk, gjendet ne situata qe sjellin mungese te aftesise paguese te dividenteve, palet bien dakord te ndryshojne afatet e shlyerjes se cmimit te kesaj Kontrate, nepermjet nje amendamenti nenshkruar ndermjet tyre.

Neni 3.03 Kamate-vonesa

(a) Për çdo ditë vonesë të pagimit të Kësteve, Blerësit do t'i ngarkohet një penalitet në masën e kamatëvonesës ligjore sipas ligjit nr. 48/2014 *"Për Pagesat e Vonuara në Detyrimet Kontraktore e Tregtare"*, të ndryshuar

(b) Mënyra e Pagimit. Pagesa Kamate-vonesave të parashikuara më sipër do të bëhet një herë në muaj, në Llogarinë e Shitësve.

Neni 3.04 Marrëveshja Siguruese

Njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Palët do të lidhin një marrëveshje siguruese në përputhje me ligjin nr.8537 datë 18.10.1999 *"Për barrët siguruese"*, i ndryshuar, për sigurimin e ekzekutimit të Detyrimeve ("**Marrëveshja Siguruese**").

Neni 3.05 Kalimi i Titullit të Pronësisë mbi Kuotën

(a) Palët bien dakord se kalimi i titullit të pronësisë mbi kuoten e shitur nga Shitësi te Blerësi ndodh në Datën e Nënshkrimit te kesaj kontrate.

(b) Në Datën e Nënshkrimit, Shitësi humb pronësinë e tij mbi pjesen e kuotes se shitur.

KREU IV. KONFIDENCIALITET

Neni 4.01 Konfidencialiteti

(a) Detyrimi për Ruajtjen e Konfidencialitetit. Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me dispozita të tilla të Kontratës, shtojcave të kësaj Kontrate si dhe çdo të dhëne të krijuar dhe mbajtur në përputhje me këtë Kontratë, që përcaktohen më poshtë si Informacione Konfidenciale apo që janë rezultat i negociatave mes Palëve.

(b) Periudha e Konfidencialitetit. Blerësi është i detyruar të ruajë Informacionin Konfidencial si tepër sekret për një periudhë të përhershme.

(c) Përjashtime. Ky nen nuk zbatohet në rastin kur Informacioni Konfidencial:

(i) kërkohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm, me kushtin që Blerësi të ketë ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë praktikë për të penguar këtë përhapje;

(ii) Shitësit kanë dhënë miratimin paraprak me shkrim për përhapjen e Informacionit Konfidencial;

(iii) është bërë përgjithësisht i disponueshëm për publikun apo literaturën pa ndonjë shkelje nga ana e Blerësit;

(iv) u jepet Palëve që duhet dhe në shkallën që nevojitet për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;

(v) zakonisht është i disponueshëm, përveç rasteve kur sigurohet si rezultat i shkeljes së detyrimeve në këtë Kontratë;

(vi) u jepet këshilltarëve profesionistë të Palëve; dhe

(vii) jepet për të zbatuar një urdhër të gjykatës apo një urdhër rregullator të një Entiteti Qeveritar.

KREU V. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 5.01 Të Drejtat dhe Detyrimet e Blerësit

Përveç të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, Blerësi ka dhe të drejtat e detyrimet si më poshtë:

(a) Pronësia mbi Kuotën. Secila nga Palët ka të drejtë të regjistrojë këtë kontratë në QKB.

(b) Disponimi. Për sa kohë është në fuqi Kontrata e Opsionit ndërmjet paleve dhe Marrëveshja Siguruese, Blerësi nuk mund të kryejë asnjë veprim material apo juridik, barrësimi, disponimi, ndarje, bashkimi, përthithje, shndërrimi, pjesëtimi, transferimi, tjetërsimi apo cedimi në asnjë lloj forme apo mënyre mbi kuoten, objekt i kesaj kontrate, plotësisht apo pjesërisht, te persona të tretë, në asnjë lloj forme apo mënyre. Ndryshimi i pronësisë së Kuotes nga Blerësi është i lejuar vetëm në mënyrat e parashikuara në Marreveshjen ndërmjet palëve nënshkruese te kësaj kontrate, (Kontrata e Opsionit) Marrëveshjes Siguruese dhe sipas Neni 7.02 (Mbarimi i Kontratës) të kësaj Kontrate.

(c) Dividenti i vitit 2023, qe i takon Shitesit per periudhën qe eshte ortak i shoqerise Infosoft Systems shpk, pra nga data 01.01.2023 deri ne datën e nënshkrimit te kesaj kontrate, do ti paguhet si divident, ne vitin 2024, ne përpjestim me shperndarjen e dividentit ndaj ortakeve.

(d) Pagesa e Çmimit. Blerësi është i detyruar të paguajë Çmimin sipas parashikimeve të bëra te KREU III (*Çmimi dhe Mënyra e Pagesës*) i kësaj Kontrate.

Neni 5.02 Të Drejtat dhe Detyrimet e Shitësit

Përveç të drejtave dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, Shitësi ka dhe të drejtat e detyrimet si më poshtë:

(a) Marrja e Pagesës së Çmimit. Shitësi ka të drejtë të marr Çmimin brenda afateve dhe procedurave siç parashikohet në Neni 3.02(b) *(Mënyra e Pagesës; Kështet dhe Afatet)* të kësaj Kontrate.

(b) Informacioni Konfidencial. Shitësi ka detyrimin të mos përdorë apo përhapë Informacionet Konfidenciale sipas parashikimeve të bëra te kjo Kontrate.

KREU VI. DEKLARIMET, GARANCITË DHE PREMTIMET E PALËVE

Neni 6.01 Deklarimet dhe Garancitë e Palëve

(a) Autoriteti; Nënshkrimi dhe Dorëzimi; Zbatimi. Secila nga Palët ka tagër dhe autoritet të plotë juridik për të nënshkruar këtë Kontratë dhe për të kryer transaksionet e përmendura në të. Secila nga Palët e ka nënshkruar dhe ia ka dorëzuar Palës tjetër këtë Kontratë të nënshkruar sipas rregullave dhe kjo Kontratë përbën detyrim të vlefshëm, të ligjshëm, të detyrueshëm dhe të zbatueshëm të secilës Palë në përputhje me kushtet dhe detyrimet që përmban Kontrata dhe Legjislacioni i Zbatueshëm.

(b) Nuk ka dijeni për Deklarata të Pasakta. Secila nga Palët nuk ka dijeni që ndonjë nga deklarimet, garancitë apo premtimet e bëra nga vetë Pala apo nga Pala tjetër në këtë Kontratë mund të mos jenë të vërteta apo të sakta.

(c) Mungesa e Shkakut që Sjell Pavlefshmërinë. Secila nga Palët nuk ka dijeni për ndonjë shkak që mund të sjellë pavlefshmërinë e Kontratës apo ndonjë neni të saj.

(d) Procedura Gjyqësore. Secila nga Palët deklaron se në dijeninë e tij nuk ka asnjë gjykim, veprim, procedurë apo hetim në ndonjë gjykatë apo institucion tjetër (i) që mund ta ndalojë atë të nënshkruajë këtë Kontratë, (ii) që ka qëllim ndalimin e kryerjes së veprimeve që janë objekt i kësaj Kontrate, ose (iii) që mund të ndalojë apo që mund të ndikojë thelbësisht dhe negativisht në përmbushjen e detyrimeve të një Pale sipas kësaj Kontrate, ose vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj.

Neni 6.02 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

(a) Pronësia. Shitësi deklaron se në dijeninë e tij dhe në bazë të vendimeve të Entiteve Qeveritare kanë titull të ligjshëm pronësie mbi Kuoten që do të shes sipas kësaj Kontrate. Shitësi deklaron se, për aq sa ai ka dijeni, Kuota e tij nuk eshte tjetërsuar në një nga format që parashikon Legjislacioni i Zbatueshëm, dhe se Shitësi nuk ka lidhur asnjë kontratë apo marrëveshje me objekt shitjen, kufizimin apo barrësimin e Kuotes dhe se Kuota eshte e lire nga çdo Barrë, apo të drejta të tjera të Personave të tretë.

(b) E Drejta Ligjore e Shitjes. Shitësi deklaron se ka të drejtën ligjore të shes Kuoten, objekt i kësaj Kontrate dhe të kryejë kalimin e pronësisë së tij te Blerësi në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

(c) Informacion i Vërtetë. Shitësi deklaron se në dijeninë e tij, i gjithë informacioni i shkëmbyer me Blerësin në këtë Kontratë është i plotë dhe i vërtetë në të gjitha aspektet.

(d) Regjistrimi. Shitësi deklaron se me nënshkrimin e kesaj kontrate, Palët mund të kryejnë depozitimin dhe regjistrimin e Kontratës në QKB sipas procedurës përkatëse dhe parashikimeve të bëra te Neni 3.05 (*Kalimi i Titullit të Pronësisë mbi Kuotën*) të kësaj Kontrate.

Neni 6.03 Premtimet e Palëve

(a) Bashkëpunimi. Palët premtojnë dhe marrin përsipër që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën gjatë gjithë kohës në mirëbesim, si dhe do të sigurohen dhe do të bëjnë të mundur që punonjësit apo konsulentët e tyre të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mirëbesim, dhe të kryejnë të gjitha veprimet dhe të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm dhe që janë të

nevojshëm për, ose lidhur me, vënien në zbatim dhe plotësimin e detyrimeve dhe kushteve të kësaj Kontrate, përfshirë, pa u kufizuar, të nënshkruajnë dokumente të tjera të nevojshme për të kryer e dhënë fuqi të plotë parashikimeve të kësaj Kontrate dhe qëllimeve të Palëve të pasqyruara në të.

(b) Veprime të Arsyeshme. Palët premtojnë dhe marrin përsipër që do të veprojnë gjithmonë në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm gjatë ushtrimit të drejtave apo diskrecionit që u është dhënë nga kjo Kontratë.

KREU VII. HYRJA NË FUQI DHE MBARIMI I KONTRATËS

Neni 7.01 Hyrja në Fuqi

Kjo Kontratë hyn në fuqi në Datën e Nënshkrimit te saj.

Neni 7.02 Mbarimi i Kontratës

(a) Rastet e Mbarimit të Kontratës. Kjo Kontratë do të konsiderohet se është zgjidhur dhe do të revokojë efektet në rast se:

(i) Palët bien dakord vullnetarisht që të zgjidhin këtë Kontratën;

(ii) Legjislacioni i Zbatueshëm dikton zgjidhjen e kësaj Kontrate; ose

(iii) Aplikohen të drejtat e Shitësit siç parashikohen ne Kontraten e Opsionit nënshkruar dhe rene dakord ndërmjet palëve.

(b) Mosekzekutimi i Kontratës. Në rast se ndodh një ngjarje që sjell mbarimin e kësaj Kontrate, sipas paragrafit të mësipërm, Blerësi, nuk ka të drejtë të refuzojë revokimin e kësaj Kontrate dhe kthimin e pronësisë së Kuotes Shitësit sipas kushteve te rena dakord ne Kontraten e Opsionit qe do te lidhet ndërmjet paleve.

(c) Pasojat e Zgjidhjes. Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate, Shitësi do të marre sërish në pronësi Kuoten në masën që i kishte para lidhjes së kësaj Kontrate.

Neni 7.03 Mbijetesa e Dispozitave

Pavarësisht zgjidhjes apo mbarimit të Kontratës, dispozitat e parashikuara ne Kreun IV (*Ndalimi i Uljes së Imazhit, Mosndërhyrja dhe Konfidencialiteti*), Neni 6.02 (*Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit*), Neni 9.01 (*Dëmshpërblimi*), KREU VIII (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*), Neni 10.01 (*Forca madhore*), Neni 10.05 (*Veçueshmëria*), Neni 10.09 (*Asnjë Interpretim Kundër Hartuesit*) dhe Neni 10.10 (*Të Kuptuarit e Dispozitave*) të kësaj Kontrate do të mbijetojnë dhe do të vazhdojnë të jenë në fuqi edhe pas zgjidhjes ose mbarimit të Kontratës sipas KREU VII (*Hyrja në Fuqi dhe Mbarimi i Kontratës*), në përputhje me afatet e parashikuara në këtë Kontratë, nëse ka.

KREU VIII. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 8.01 Përpjekjet për Mirëkuptim

Palët bien dakord se do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim, çdo ankesë, debat, apo mosmarrëveshje që vjen si pasojë ose lidhet me këtë Kontratë.

Neni 8.02 Gjykata Kompetente

Në rast se Palët nuk arrijnë t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Palëve, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8.03 Legjislacioni i Zbatueshëm

Kjo Kontratë është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

KREU IX. DËMSHPËRBLIMI

Neni 9.01 Dëmshpërblimi

Në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, secila nga Palët (në cilësinë e saj si palë zhdëmtuese, në vijim "**Pala Dëmshpërblyese**") pranon të dëmshpërblejë Palën tjetër (në cilësinë e saj si palë e dëmshpërblyer, në vijim "**Pala e Dëmshpërblyer**") dhe ta mbrojë atë nga çdo Dëm i shkaktuar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, që bazohet në, lind nga, apo rrjedh prej, pa u kufizuar në, mospërmbushjen nga Pala Dëmshpërblyese të detyrimeve, deklarimeve, garancive, kushteve apo premtimeve të tjera të përfshira në këtë Kontratë.

Neni 9.02 Pretendime nga Palë të Treta

(a) Mbrojtje nga Pala Dëmshpërblyese. Menjëherë pas (i) marrjes dijeni të ndonjë fakti, ndodhie ose ngjarje që mund të rezultojë në një Pretendim në bazë të kësaj Kontrate; ose (ii) marrjes së një njoftimi për ndonjë Pretendim nga një Person palë e tretë ndaj Palës së Dëmshpërblyer, Pala e Dëmshpërblyer do të njoftojë me shkrim Palën Dëmshpërblyese për natyrën dhe bazën e Pretendimit. Pala Dëmshpërblyese ka të drejtë të bëjë mbrojtjen nga Pretendimi me shpenzimet e saj dhe duke përzgjedhur këshilltarët e saj, të cilët duhet të jenë të pranueshëm dhe për Palën e Dëmshpërblyer, me kusht që (x) brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Pala e Dëmshpërblyer, Pala Dëmshpërblyese e njofton Palën e Dëmshpërblyer që do ta bëjë këtë mbrojtje, dhe (y) Pala Dëmshpërblyese nuk mund të nënshkruajë ndonjë marrëveshje pajtimi me palën pretenduese pa miratimin e Palës së Dëmshpërblyer.

(b) Mbrojtje nga Pala e Dëmshpërblyer. Në rast se Pala Dëmshpërblyese refuzon të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit (i) Pala e Dëmshpërblyer do të mbrohet vetë kundër Pretendimit dhe (ii) Pala Dëmshpërblyese do të mbetet përgjegjëse për çdo Dëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që mund t'i vijë Palës së Dëmshpërblyer si rezultat i Pretendimit. Pavarësisht se cila Palë do të marrë përsipër mbrojtjen ndaj Pretendimit, secila Palë do t'i vendosë në dispozicion Palës tjetër, pas kërkesës së saj, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e arsyeshëm dhe të nevojshëm për të mbështetur procesin e mbrojtjes ndaj Pretendimit si dhe për të verifikuar çdo Dëm që shkaktohet nga Pretendimi.

KREU X. TË NDRYSHME

Neni 10.01 Forca Madhore

(a) Nuk Konsiderohet Shkelje. Vonesa në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate prej njërës nga Palët nuk do të quhet shkelje ose mospërmbushje e kësaj Kontrate në rast se vjen si rrjedhojë e Forcës Madhore me kusht që (i) Pala e prekur nga kjo ngjarje të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, dhe (ii) të ketë njoftuar Palën tjetër brenda 5 (pesë) Ditëve Pune nga ndodhja e ngjarjes, duke specifikuar saktësisht llojin e Forcës Madhore dhe arsyet pse e bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimit përkatës.

(b) Zgjatje e Periudhës. Çdo periudhë brenda së cilës, njëra nga Palët sipas kësaj Kontrate, duhet të kryejë apo përmbushë një veprim ose detyrim, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën gjatë së cilës kjo Palë, nuk mund të kryejë këtë veprim apo përmbushë atë detyrim për shkak të Forcës Madhore. Në rast se pasojat e shkaktuara nga Forca Madhore janë të tilla që duhet bërë një modifikim i Kontratës, Palët bien dakord të fillojnë negociatat në mirëbesim për një ndryshim të Kontratës për të rregulluar pasojat e Forcës Madhore.

Neni 10.02 Transferimi i te drejtave

Kjo Kontratë është lidhur vetëm mes Palëve dhe mund të zbatohet vetëm prej tyre. Kjo Kontratë nuk mund të interpretohet në asnjë rast se krijon të drejta për ndonjë palë të tretë, përfshirë punonjësit, agjentët, përfaqësuesit, kontraktorët, furnizuesit ose konsumatorët e një Pale. Një Person i cili nuk është Palë në këtë Kontratë nuk gëzon asnjë të drejtë sipas kësaj Kontrate .Kalimi i te drejtave nepermjet Cedimi, Transferimi, Zëvëndësimi, nuk lejohet përveç rasteve te parashikuara ne marrëveshje ndërmjet paleve.

(a) Blerësi. Të drejtat dhe detyrimet që Bleresi ka në bazë të kësaj Kontrate janë të trashegueshme dhe Shitesi jep miratim per zbatimin e ketij paragrafi nepermjet kesaj Kontrate.

(b) Shitësi. Të drejtat dhe detyrimet që Shitësi ka në bazë të kësaj Kontrate janë lirisht të trashegueshme dhe Bleresi jep miratim per zbatimin e ketij paragrafi nepermjet kesaj Kontrate.

Neni 10.03 .Njoftimet

(a) Metoda e Njoftimit. Njoftimet dhe çdo lloj tjetër komunikimi në lidhje me këtë Kontratë do të jetë me shkrim dhe në gjuhën shqipe dhe duhet të bëhet në përputhje me këtë nen. Njoftimi do të bëhet: (i) duke e dorëzuar personalisht, me kundërfirmë; ose (ii) dërguar me postë të parapaguar me konfirmim dorëzimi nga Pala marrëse në adresën e përcaktuar ne këtë Kontratë, apo ndonjë adresë tjetër të specifikuar nga Pala përkatëse. Në shtesë të sa më lart, po pa u konsideruar njoftim, Palët do t'i dërgojnë njoftimet e tyre me e-mail (në adresat e komunikuara njera-tjetres), dhe në çdo rast e adresuar qartësisht për vëmendjen e Palës përkatëse.

(b) Koha e Njoftimit. Çdo njoftim, i dërguar sipas mënyrave të mësipërme do të konsiderohet si i dorëzuar sipas rregullave dhe në kohën e specifikuar si më poshtë:

(i) Në rastin e dërgimit dorazi, kur dorëzimi kryhet te përfaqësuesit e Palës marrëse gjatë Ditës së Punës dhe dorëzimi është pranuar me shkrim nga Pala;

(ii) Në rastin e njoftimit me postë të parapaguar, në mungesë të provave që njoftimi është marrë më parë, njoftimi konsiderohet i dhënë, nëse është dërguar me postë, 5 (pesë) Ditë Pune pas postimit;

(c) Ndryshimi i Adresës ose Emrit. Secila Palë do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër të kësaj Kontrate për të dhënat e kontaktit.

Neni 10.04 Heqja Dorë

Asnjë mospërmbushje ose vonesë në përmbushje nga secila Palë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompetence të parashikuar në këtë Kontratë nuk mund të konsiderohet si heqje dorë, dhe as ushtrimi i pjesshëm apo vetëm i një të drejte, as braktisja ose mosndjekja e hapave të mëtejshëm për t'i zbatuar këto të drejta apo kompetenca, nuk do të intepretohet në asnjë rast si arsye për t'u bërë pengesë që Pala të ushtrojë në një kohë tjetër këto të drejta apo kompetenca, apo të ushtrojë në çdo rast të drejta apo kompetenca të tjera.

Neni 10.05 Veçueshmëria

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate konsiderohet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një Entitet Qeveritar, kësaj dispozite nuk do t'i jepet asnjë efekt dhe do të konsiderohet se nuk është përfshirë në këtë Kontratë, por pa shfuqizuar dispozitat e tjera të Kontratës. Dispozita e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme, të përshtatshme, të vlefshme, të zbatueshme dhe që i afrohet sa më shumë synimit dhe qëllimit të dispozitës së paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme.

Neni 10.06 Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

Neni 10.07 Ndryshimet

Ndryshimet e kësaj Kontrate, janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja Palët.

Neni 10.08 Shpenzimet

Përveç kur është shprehur specifikisht ndryshe në këtë Kontratë, secila Palë është përgjegjëse për çdo shpenzim në lidhje me negocimin apo nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

Neni 10.09 Asnjë Interpretim Kundër Hartuesit

Palët pranojnë që kjo është një Kontratë e negociuar. Fakti që njëra Palë e Kontratës (apo këshilltarët e tij) ka hartuar Kontratën apo një dispozitë të caktuar të saj apo se ajo përfiton nga ajo dispozitë nuk do të përdoret kundër saj në interpretimin e kushteve të Kontratës.

Neni 10.10 Të Kuptuarit e Dispozitave

Palët pranojnë dhe janë dakord se ato i kanë lexuar dhe kuptuar kushtet, detyrimet dhe të drejtat e lindura nga kjo Kontratë dhe se ata kanë pasur mundësinë të këshillohen me juristë sipas zgjedhjes së tyre.

Neni 10.11 Kopjet e Njëjta

Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në disa kopje, dhe çdonjëra prej të cilave kur është e nënshkruar dhe dorëzuar nga të dy Palët në mënyrë të rregullt, do të konsiderohet si origjinale dhe të gjitha së bashku do të përbëjnë një dokument të vetëm.

PALËT bien dakord me kushtet, të drejtat dhe detyrimet sa më lart dhe e nënshkruajnë këtë Kontratë më poshtë në datën 08.05.2023.

Shitësit	**Blerësi**
Z. Grigor Joti	**Z. Bledar Dhima**
Grigor Joti	BLEDAR DHIMA
Japin miratimin:	
Marjeta JOTI	**Mirela DHIMA**
Marjeta Joti	Mirela Dhima